



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE**



**PROGRAMI I LËNDËS
GJUHË E SHKRUAR FRËNGE 2**

Ngarkesa: 4 ECTS, 40 orë seminare

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti I, semestri 2

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme,

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshëm:

Kjo lëndë synon të zhvillojë kompetencën e të kuptuarit të teksteve të shkruara dhe të të shprehurit me shkrim në gjuhën frënge në bazë të Kuadrit evropian të referencës për gjuhët. Studenti aftësohet:

- për të përpunuar materiale
- për të komunikuar me shkrim

Objektiva specifike:

- Të mësojë të hartojë një plan për t'u shprehur me shkrim
- Të mësojë të komunikojë me shkrim
- Të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi burimet e ndryshme dhe literaturën e shfrytëzuar.

Rezultatet e të nxënit: Pas mbarimit të lëndës studenti është i aftë të:

- Të lexojë dhe kuptojë tekste në gjuhën frënge ;
- Të përfitojë nga një fjalor i pasuruar (emocionet, mendimi , shoqëria, politika, feja arti, etj.) ;
- Të përfitojë nga studimi i thelluar i zotërimit të fjalisë (natyra, modaliteti, ritmi, struktura dhe ortografi) si dhe nga arti i paragrafëve ;
- Të përdorë format e ndryshme të ligjëratës (rrëfimore, përshkruese, shpjeguese, argumentuese) ;
- Të shkruajë një kartolinë
- Të shkruajë letër shoqërore, letër zyrtare ;
- Të shkruajë një curriculum vitae, një letër motivimi, etj.,.
- Të shkruajë një email shoqëror / një email zyrtar
- Të shkruajë një SMS shoqëror/ një SMS zyrtar
- Të shkruajë një përmbledhje në PowerPoint